



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 578 Akti

Nr. 626 Vendimi
Tiranë, më 27.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, më datë 27.2.2023 mori në shqyrtim, mbi bazën e dokumenteve të administruara, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Mihallaq Bleta**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “c” e pikës 1 të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 30.1.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me të

cilin ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë të z. Mihallaq Blea, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Mihallaq Blea, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë e më pas ka qenë i komanduar dhe angazhuar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Mihallaq Blea, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Genta Tafa (Bungo). Më tej, të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

- a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Ndërkohë që procesi i rivlerësimit ishte në vijim, në datën 8.2.2023, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është njoftuar vendimi nr. ***, datë 30.1.2023, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për mbarimin e statusit të magjistratit” me të cilin, me propozimin e komisionit për zhvillimin e karrierës, është vendosur “Mbarimi i statusit të magjistratit për shkak mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë të z. Mihallaq Blea”. Ky vendim i është njoftuar organeve kompetente: Prokurorisë së Përgjithshme; Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; dhe z. Mihallaq Blea.

6. Në këto kushte, në vijim të njoftimit të vendimit të deklarimit të mbarimit të statusit të magjistratit, z. Mihallaq Blea – rrethanë kjo që pamundëson objektin e procesit të rivlerësimit – me qëllim konkludimin brenda proceduarve të një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në datën 13.2.2023, nëpërmjet postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shprehte vullnetin e tij lidhur me paraqitjen në seancë publike për t’u dëgjuar lidhur me mbarimin e statusit të tij si magjistrat, si dhe të deklaronte nëse kishte ushtruar ankim ndaj vendimit të lartpërmendur të KLP-së.

7. Subjekti i rivlerësimit, duke u përgjigjur nëpërmjet postës elektronike të datës 14.2.2023, bëri me dije se nuk ishte i interesuar të merrte pjesë në seancë dëgjimore dhe se nuk kishte ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***/2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke konfirmuar dhe rishprehur kështu vullnetin e tij të pavesuar në raport me humbjen e statusit të magjistratit.

8. Gjithashtu, në vijim të njoftimit të vendimit të KLP-së për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, z. Mihallaq Blea, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2023, i kërkoi informacion Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2023, i bëri me dije Komisionit se deri në datën 16.2.2023 nuk është paraqitur ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 30.1.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

9. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se në mënyrë të përmbledhur janë konstatuar këto fakte: (i) KLP-ja, me vendimin nr. ***, datë 30.1.2023, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak mbushjes së moshës 67 vjeç, për z. Mihallaq Blea; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 30.1.2023, të KLP-së, për mbarimin e statusit të magjistratit; (iii) subjekti është shprehur se nuk kishte interes të merrte pjesë në një seancë publike lidhur me mbarimin e statusit të tij si magjistrat. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana përbëjnë shkak për përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TE RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11. Trupi gjykues konstaton se z. Mihallaq Blea ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, referuar përkufizimit të termit “magjistrat” në ligjin nr. 96/2016, në germën “gj” të nenit 2, në kuptim të germës “g” të këtij neni.

12. Në germën “b” të pikës 1 të nenit 164 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, por ky status do të mbahet vetëm nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit dhe konfirmohen në detyrë.

13. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. ***, datë 30.1.2023, ka vendosur të deklarojë “Mbarimin e statusit të magjistratit për z. Mihallaq Bleta, për shkak mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë”, vendim i cili i është njoftuar edhe Komisionit.

14. Bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 64, pika 1, germa “c”, përcaktohet se: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:*

c- mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; ç - [...]”.

15. Në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit i cili plotëson kushtet e parashikuara në ligj për daljen në pension pleqërie, si më poshtë vijon:

“5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. [...] Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ... [...]. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës”.

16. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë 67 vjeç, ka shprehur vullnetin e tij për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës, rast në të cilin, sipas përcaktimit ligjor, mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet nga KLP-ja, e në aplikim të nenit 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, i ka mbaruar statusi i magjistratit pikërisht për këtë shkak ligjor.

17. Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit i ka mbaruar statusi i magjistratit për një nga rastet e parashikuara nga ligji, Komisioni vlerëson se bazuar në ligjin nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, ku parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

18. Në rastin konkret çmohet i aplikueshëm neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, pasi objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar apo qëllimi i këtij procesi rivlerësimi, është bërë i pamundur, pasi subjektit i ka mbaruar statusi i magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit. Konkretisht, bazuar në parashikimin e nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative, “Pamundësia në objekt apo qëllim” ku specifikohet se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”, vlerëson se objekti dhe qëllimi që synon procedura e rivlerësimit është bërë i pamundur.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germën “c” të pikës 1 të nenit 64 dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Mihallaq Bleta, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pa një vendim përfundimtar të çështjes, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura e rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur.
 2. Ky vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall sot, në datën 27.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli